

“NATA SHENJTE, NATA NËNË E TË GJITHA NETËVE TË KRISHTERIMIT” (SHËN AUGUSTIND)

Të dashur lexues, do të mundohem me pak fjalë të paraqes ciklin e kohës së shenjtë të Pashkëve me qëllim që edhe këta pak rreshta të jenë një ndihmë për përgatitjen sa më të mirë për këto festa, poashtu, edhe për inkuadrimin sa më të mirë si pjesëmarrës që do të jemi në kremtimin e riteve të kësaj kohe, e sidomos të natës së shenjtë kur kremtojmë Ngjalljen e Jezu Krishtit. Pra, po filloj me kohën e Kreshmëve e cila na thërret në përmirësimin e gjendjes sonë shpirtërore që edhe ne ta përfjetojmë në shpirtë ngadhënjimin dhe fitoren e të mirës mbi të keqen.

POROSIA E KOHËS SË KRESHMËVE

Është kjo kohë e shenjtë prej 40-ditësh e cila fillon të mërkurën e Përhimë dhe i paraprinë festës së Pashkëve e cila thërret besimtarët në pendesë, lutje dhe kthim shpirtërorë.

Gjatë kësaj kohe sidomos theksohet largimi prej mëkateve në njërin anë, e në anën tjetër porositen besimtarët të lusin për mëkatarë (SC 109). Shën Augustini shkruan kështu: “*Këto ditë të shenjta të Dyzetditëshit na obligojnë që tu flasim mbi dashurinë vëllazërore dhe detyrën që t’i jepni fund urrejtjes ndaj vëllezërve t’uaj, nëse vetë nuk dëshironi të sharroni (...) Kemi lidhur besëlidhje me Zotin dhe kemi nënshkruar kushtin, pa të cilin nuk mundë të na falen fajet tona*”.

Na e bëjnë me dije edhe këto fjalë të shën Augustinit se sa e rëndësishme është që njeriu ta luftojë mëkatin.

Mundë të them se gjatë kësaj kohe shenjte, Kisha e gjithmbarshme, por edhe çdo besimtarë i saj e ka rastin tejet të volitshëm që t’i përfjetojë “Ustrimet shpirtërore” të vetat duke e shfrytëzuar këtë kohë sa më mirë e që është: Le të thellohem dhe të gjurmojmë në thellësitë e zemrës, të nxjerrim dhe të flakim jashtë saj çdo gjë që e shëmton atë. Një tentativë e tillë do ta mundësojë ballafaqimin me vetveten dhe njohjen më të mirë të realitetit të jetës tëndë. Kjo do të rezultojë me pranimin e kësaj gjendje për të vazhduar kah përmirësimi i saj. Nëse veprohet në këtë mënyrë, në fytyrën tëndë do të mundë të lexohet harmonia shpirtërore e cila gjithashtu për efekt do të ketë komunikimin më të mirë me të afërmin.

Kjo kohë shenjte veçohet po ashtu për nga devocioni i Udhës së Kryqit të cilën e lusim e që për qëllim e ka njohjen më të thellë të gjithë asaj çka Krishti vuajti për ne. Le të solidarizohemi me Krishtin që edhe vuajtjet tona ta gjejnë kuptimin në kryqin e Krishtit.

Pra, gjatë kësaj kohe le të mbizotërojnë falja, le t’i harrojmë padrejtësitë, le të përfundojnë hakmarrjet që festat e Pashkëve të na gjejnë sa më të kënaqur.

JAVA E MADHE

E DIELA E LARIT (E diela e Luleve)

Emri i vjetër i kësaj të diele në liturgji ishte <<dominica de passione Domini>> (shek.IV-V). Më vonë ajo quhet <<Dominica palmarum>> ose <<Dominica in palmis>>. Kjo është ruajtur deri në ditët tona, kështuqë, me reformën e Koncilit të II të Vatikanit këto dy shprehje përmblihen në një: <<Dominica in palmis de passione Domini>> - E diela e Larit e Mundimeve të Krishtit.

Në vendet ku nuk kishte palma kjo e diel është quajtur sipas lulës që është përdorë në vend të tyre, psh. <<Pascha florum>> ose <<Pascha floridum>>. (Emri i siujdhesës amerikane Florida ka këtë prejardhje. Gjatë një ekspedite marinarët e panë këtë siujdhesë në këtë të diel dhe e quajtën po me këtë emër).

Liturgjia e kësaj dite ndahet në dy pjesë. Bekimi i rrembave që vazhdon me procesion dhe përkujtimi kremtor i Mundimeve dhe vdekjes së Krishtit. Duke përkujtuar hyrjen mesianike në Jeruzalem (Mt 21, 1-10; Mk 11, 1-11; Lk 19, 28-38; Gjn 12, 12-19), si dhe Mundimet e Krishtit gjatë Javës së madhe, duhet të angazhohemi që edhe më mirë të përgatitemi për Ringjalljen e Krishtit, i cili me Ringjalljen e vet do ti jep kuptim jetës sonë.

TREDITËSHI SHENJTË

Festën e Pashkëve në fillim Kisha e ka festuar vetëm një ditë edhe atë natën në mes të Shtunës së madhe dhe të dielës së Pashkëve. Më vonë (gjatë shek. IV) zhvillohet “**Treditëshi shenjtë i Zotërisë së kryqëzuar, varrosur dhe ringjallur**”. Kremtimi liturgjik i këtyre tri ditëve fillon në mbrëmjen e të Enjtes së madhe deri të dielën e Pashkëve.

E ENJTJA E MADHE

Të Enjten e madhe kremtohet Mesha e darkës së Mbramë që duhet të jetë e vetmja atë ditë (duke mos përfshi këtu Meshën e shugurimit të vajrave e kremtuar prej ipeshkvit). Me Këtë meshë është e ndërlidhur tradita e larjes së këmbëve (traditë e ashtuquajtur *mandatum* – urdhër). Me këtë gjest shprehet çartë porosia e Krishtit që u jep apostujve, të jenë gjithmonë në shërbim të besimtarëve. Gjatë kësaj meshe shugurohen hostjet për të Premtën e madhe të cilat vendosen në një tabernakull (në kapelë ose të përgatitur për këtë rast në ndonjë vend të përshtatshëm në kishë) ku mundë të bëhet adhurimi para të Shenjtërueshmit Sakrament (Varrit shenjt). Më pas vazhdon zbulimi i lterit kryesor si shenjë zie e mbarë Kishës, si dhe duke marrë parasysh se të Premtën e madhe dhe të Shtunën e madhe nuk ka meshë por përkujtohen Mundimet dhe vdekja e Krishtit. Po përmendi këtu edhe traditën se kur thuhet *Lavdia* bien kambanat të cilat pushojnë e nuk bien më deri në *Lavdinë* e Vigjiljes së Pashkëve.

E PREMTJA E MADHE

Liturgjia e të Premtes së madhe sot përmban tri pjesë: **Shërbesën e fjalës; Adhurimin e Kryqit dhe kungimin.**

Kjo ditë për të krishterët në gjithë botën është ditë agjërimi. Kisha porosinë që ky agjërim të mbahet deri në Vigjiljen e Pashkëve. Që në fillim të riteve të kësaj dite meshtari shtrihet para lterit, besimtarët bien në gjunjë dhe të gjithë për pak kohë luten në heshtje. Në shërbesën e fjalës vëmendja është e përqendruar në leximin e Mundimeve të Krishtit.

“*Kryqi, dru dhimbjesh e vuajtjesh, lter gjaku e flije zen vendin e parë në ritet fetare*”... *Kështu, “me adhurimin e Kryqit besimtarët ndjekin shpirtërisht tragjedinë e Golgotës, të paraqitun aq gjallë e aq thekshëm në Ungjillin e shën Gjonit*” (Meshari i të kremteve, At D. Gjeçaj, Romë 1966). Pas leximit të Mundimeve të Krishtit mbahet një homeli e shkurtër dhe vazhdohet me lutjet e gjithmbarshme. Më pas bëhet adhurimi i Kryqit për të përfunduar me pjesën e tretë që është kungimi.

Sot, më mirë se kurrë, e kuptojmë se të kungohesh me Korpin e Krishtit d. t. th. të marrësh pjesë në flijen e tij – të dish t’i pranosh edhe vuajtjet nga dashuria për të afërmin.

E SHTUNA E MADHE

Në këtë ditë nuk ka kremtim të Eukaristisë e as të shërbesës së fjalës, por me mendje e zemër lutemi duke përkujtuar Krishtin në varr i cili pret momentin e ngjalljes së vet të lavdishme.

VIGJILJA E PASHKËVE E NATËS SË SHENJTË

Vigjilja e Pashkëve sot përmban këto katër pjesë:

- 1) **Shërbesa e dritës:** Bashkësia gjendet afër qiriut të Pashkëve që është simbol i Krishtit, dritës së botës.
- 2) **Shërbesa e fjalës:** Kur mendojmë mbi veprat e mrekullueshme të cilat që nga fillimi Zoti i ka bërë në popullin e vet.
- 3) **Shërbesa e pagëzimit:** Sakrament ky përmes të cilit kemi kaluar nga vdekja në jetë. Bëhet përsëritja e premtimeve të pagëzimit, dhe
- 4) **Shërbesa eukaristike:** Populli i Zotit i rilindur me pagëzim paraqet flijen në Përkujtim të Krishtit, si shenjë falënderimi dhe ushqehet me Korpin e Krishtit të ngjallur.

Shën Augustini për këtë natë shkruan kështu: *Nata e Pashkëve është “Nata shenjte, nata nënë e të gjitha netëve të krishterimit”.*

Në shërbesën e dritës të kësaj nate duhet të veçohen momentet si psh. bekimi i zjarrit që është shenjë e jetës që shndritë dhe ngrohë. Më pas në qiriun e Pashkëve meshtari gdhendë një kryq. Mbi të vihet shkronja greke Alfa ndërsa nën të shkronja Omega. Në katër anët e kryqit vihen katër numrat e vitit vijues, pastaj mundë të vihen pesë kokrrat e kemit po ashtu në formë kryqi.

Prej zjarrit të bekuar ndizet qiriu i Pashkëve që simbolizon Krishtin e Ngjallur.

Pasi të jemi nisur drejt kishës, në hyrje të saj të gjithë ndezin qirinjtë që bartin në dorë nga qiriu i Pashkëve (Populli i Zotit udhëton në këtë botë i shndritur me dritën e Krishtit). Atëherë xhakoni, ose nëse ai nuk është, meshtari duke e lartësuar qiriun e Pashkëve këndon në hyrje të kishës, në mes dhe te lteri: *Drita e Krishtit*, në çka të gjithë përgjigjen: *Falënderojmë Hyjin*.

Pasi të vihet qiriu në shandan këndohet himni i qiriut të Pashkëve. Ky himn përmban pesë tema: *1) Ngjallja është krijim i ri; b) Dalja; Qiriu si udhëtregues i popullit (Dalja nga Egjipti); c) Qiriu është dritëza e Kishës e cila pret të Fejuarin e vet; d) Domethënia e paraqitjes së dritës dhe karakteri flijues i Pashkëve; dhe e) Simbolika e bletëve.*

Pasi të ketë përfunduar himni të gjithë fikin qirinjtë dhe ulen, vazhdon shërbesa e fjalës.

Për shërbesën e fjalës janë të paraparë shtatë lexime prej Besëlidhjes së Vjetër dhe dy prej Besëlidhjes së Re. Leximet e BV mundë të reduktohen në më së paku dy por asnjëherë nuk guxon të lihet leximi mbi daljen prej Egjiptit (Leximi i tretë).

Pas leximit të fundit të BV dhe lutjes meshtari këndon Lavdi... Vijon lutja dhe leximi i letrës nga BR. Kur ky përfundon solemnisht pas shtatë javësh këndohet **Aleluja**. Vazhdon Ungjilli dhe homelia.

Në shërbesën e pagëzimit nëse ka katekumen (të rritur për pagëzim) bëhet paraqitja e tyre si dhe e nunave, e nëse nuk ka asnjë për pagëzim ftohet bashkësia në lutje dhe bëhet bekimi i ujit. Nuk thuhet as litanitë, ndërsa bëhet përsëritja e premtimeve të pagëzimit. Nuk thuhet Besojma.

Shërbesa eukaristike është shërbesa kulmore e këtij kremtimi me të cilën shprehet kuptimi themelor i saj: Me Krishtin kalojmë nga vdekja në jetë.

Mesha vazhdon si rëndomtë me prefacion dhe lutjet e përshtatshme të kësaj të Kremte.

KOHA E PASHKËVE

Koha e Pashkëve zgjatë 50 ditë. Fillon me Vigjiljen e Pashkëve dhe përfundon me të dielën e Rrëshajave. Gjatë kësaj kohe përkujtojmë ngadhënjimin e Krishtit mbi vdekjen. Është kjo kohë gëzimi, pra, për të kënduar edhe ne “*Alelujen*” e liturgjisë duhet të ringjallemi shpirtërisht me Krishtin duke filluar një jetë të re hiri.

Don Agim QERKINI